



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C 2- (greqisht)

Ngarkesa: 6 kredite, 60 orë mësimore, 60 orë seminare

Viti / Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i shkencave në “Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh”

Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT;

Objektivat e përgjithshme lëndore: studentët do të zhvillojnë aftësitë gjuhësore për t'iu përgjigjur situatave dhe strukturave gjuhësore të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (me gojë ose me shkrim); do të njihen me rregullat shoqërore gjuhësore dhe jo-gjuhësore; do të njihen me karakteristikat themelore të kulturës greke në nivel fillestar – A1.

Objektivat specifike lëndore:

1. Studentët do të zhvillojnë katër aftësitë gjuhësore të gjuhës greke në: a. të dëgjuarit, b. të lexuarit, c. të folurit, d. të shkruarit dhe bashkëbisedimin bazë gjuhësor e ndërkulturor.
2. Të jetë i aftë të komunikojë suksesshëm me një folës natyrorë ose jo të gjuhës greke në situata ku përfshihen prezantimi, zakonet e përditshme, mendimi, ndjenjat, marrëdhëniet me të tjerët dhe çdo gjë tjetër që lidhet me jetën shoqërore (në të folur dhe në të shkruar);
3. Të jetë i aftë të kuptojë dhe shkruajë udhëzime të shkurtra dhe të shkëmbejë informacion në situatat e komunikimit si p.sh. jeta personale, blerja e mallrave dhe shërbimeve të konsumit, edukimi, jeta shoqërore dhe profesionale, argëtimi etj.
4. Të jetë i aftë të kuptojë dhe të prodhojë gjuhë të folur dhe të shkruar në ato elementë që konsiderohen të domosdoshëm në kuptimin e plotë të një teksti; të ketë saktësi gjuhësore si dëgjues, folës dhe shkruar në përdorimin e gjuhës greke dhe nivel të kënaqshëm në përkthimin e saj.

Rezultatet e pritshme:

1. Studenti do të jetë i aftë të kuptojë dhe të përdorë shprehje të thjeshta të përditshme dhe fraza të zakonshme për nevojat bazë të komunikimit (prezantimi, orientimi, blerja, etj.).
2. Studenti do të komunikojë në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në situata të zakonshme që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë mbi tema të njohura dhe personale.
3. Studenti do të kuptojë dhe shkruajë tekste të thjeshta, si udhëzime, njoftime apo mesazhe të shkurtra, duke demonstruar saktësi gjuhësore bazë dhe aftësi për përkthim të thjeshtë në kontekste të jetës së përditshme.